

BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 52 Datë 27/03/2020

“Për Përdorimin e Fondit të buxhetit të Bashkisë Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, kërkojmë që në zbatim të aktit normativ nr.5 datë 17.03.2020 “Për një shtesë në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID19”, të ndryshuar, në mbledhjen e datës 27/03/2020 me 18 vota pro, — kundër, — abstenim:

Vendosi:

- I. Nga buxheti i Bashkisë Dibër të miratohet amendimi i kontratës për materialet e pastrimit sipas aktit normativ nr.5 datë 17.03.2020, neni 5/1, për subjektin që ka patur kontratën me Bashkinë Dibër gjatë vitit 2019 me vlerë 1.308.854 lekë dhe amendimi i kontratës do të lidhet për vlerën 261.770 lekë.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia e Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria Ekonomike pranë Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETAR KËSHILLIT BASHKIAK

Inva TRUPJA  




Sokol SAVA

